



VENDIM

Nr. 3, Datë 15.05.2012

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Këshilli i Administrimit i Universitetit të Arteve në mbledhjen e tij të datës 15.05.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve,

VËREN SE

Në datën 20.02.2012 janë zhvilluar zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve. Në këto zgjedhje janë përcaktuar 4 anëtarë të Këshillit të Administrimit të Universitetit të Arteve. Ndërkohë, nga ana e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës janë emëruar tre anëtarë të këtij këshilli Administrimi. Duke pasur përbërjen e plotë, Këshilli i Administrimit, në përputhje me nenin 21, pika 3 të Statutit të UART, zhvilloi procedurat për zgjedhjen e Kryetarit, i cili zgjidhet nga anëtarët e brendshëm të Këshillit të Administrimit, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve. Në përfundim të votimit, si dhe duke iu referuar rezultatit të votimit, Këshilli i Administrimit,

VENDOSI

1. Zgjedhjen e Dr. Elida Rapti, Kryetare e Këshillit të Administrimit të Universitetit të Arteve.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE